

Emertimi i shoqerise dhe forma ligjore :	“ TIRANA EAST GATE “ Sh.p.k
NIPT :	K 82231001 H
Adresa e selise :	Rruga Nacionale, Tirane - Elbasan
Telefon :	(4) 2 380 124
Fax :	(4) 2 380 170
Data e themelimit :	21 Tetor 2008
Data e Regjistrimit ne QKR :	31 Tetor 2008
Veprimtaria kryesore :	Aktiviteti i ndertimit, prodhim materialesh ndertimi, ndermjetsim per shitblerje dhe dhenie me qera te pasurive te paluejtshme. Tregeti me shumice e pakice, Import/Eksport mallrash. Servis pajisjesh. Transport mallrash e udhetaresh, sipas objektit te veprimtarise te percaktuar ne Statut dhe aktin e regjistrimit ne QKR.

PASQYRAT FINANCIARE

Periudha kontabël e Pasqyrave Financiare :	01.01 .2014 deri 31.12.2014
Data e mbylljes së Pasqyrave Financiare :	27.03.2015
Pasqyrat Financiare janë :	INDIVIDUALE
Pasqyrat Financiare janë të shprehura në :	LEKE
Pasqyrat Financiare janë të rrumbullaksura në :	

TEG
tirana east gate
NIPT: K82231001H



Ernst&Young Certified Auditors
Ltd. Skopje - Tirana Branch
NUIŠ: K619110121
Ibrahim Rugova Str., Sky Tower
6th Floor, 1001, Tirana, Albania

Tel: (+355 4) 24 19 575
Fax: (+355 4) 24 19 570
www.ey.com

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

PËR AKSIONARËT E TIRANA EAST GATE SH.P.K

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë "Tirana East Gate sh.p.k." (më poshtë "Shoqëria") që përmbajnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 Dhjetor 2014, pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave, pasqyrën e ndryshimit të kapitalit, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, dhe një përmbledhje të politikave kontabile dhe informacione të tjera sqaruese.

Përgjegjësia e drejtimit për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), dhe për ato kontrole të brendshme, të cilat drejtimi i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimit apo gabimeve.

Përgjegjësia e auditorit

Përgjegjësia jone është të shprehim një opinion për pasqyrat financiare duke u bazuar në auditimin e kryer. Ne kryem auditimin tonë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikes dhe të planifikojmë e të kryejmë auditimin me qëllim që të përfitojmë një siguri të mjaftueshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për shumat dhe deklarimet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura janë në gjykimin e audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të pasaktësisë materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve. Gjatë vlerësimit të këtyre rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare të shoqërisë në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të shoqërisë. Një auditim gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve të kontabilitetit të përdorura dhe pranueshmërinë e çmuarjeve kontabile të kryera nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që ne kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Tirana East Gate sh.p.k paraqesin në mënyrë të sinqertë, në të gjitha aspektet materiale, gjendjen financiare të Shoqërisë më 31 Dhjetor 2014, të rezultatit të saj financiar dhe të fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Ernst & Young Certified Auditors Sh.p.k.

Skopje - Tirana Branch

Ernst & Young Certified Auditors Sh.p.k.

30 Mars 2015
Tiranë, Shqipëri

Mario Vangjel

Ekspert Kontabël i Regjistruar

Mario Vangjel

Përmbajtja


RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR.....
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	1
PASQYRA PËRMBLEDHËSE E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA E NDRYSHIMIT NË KAPITAL.....	3
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE.....	4
1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM.....	5
2. BAZAT E PËRGATITJES.....	5
3. NDRYSHIMET NË POLITIKAT KONTABËL DHE SHPJEGIMET.....	6
4. GJYKIME TË RËNDËSISHME KONTABËL, ÇMUARJET DHE VLERËSIMET	6
5. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL	7
6. STANDARDE TË PUBLIKUARA POR JO ENDE ZBATUARA	12
7. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE.....	15
8. AKTIV TATIMOR I SHTYRË.....	16
9. TË DREJTA TË ARKETUESHME	16
10. TË DREJTA TATIMORE DHE TË TJERA.....	17
11. PARAPAGIME TË DHËNA.....	17
12. TË ARDHURA TË SHTYRA	17
13. MJETE MONETARE DHE TË NGJASHME.....	17
14. HUATË NGA INSTITUCIONET FINANCIARE	18
15. KAPITALI AKSIONAR.....	21
16. DETYRIME TATIMORE.....	21
17. FURNITORË DHE TË TJERA DETYRIME	21
18. PARAPAGIME TË MARRA.....	22
19. TË ARDHURAT NGA SHËRBIMET	22
20. TË ARDHURA TË TJERA	22
21. SHËRBIMET.....	22
22. SHËRBIME OPERATIVE	22
23. SHPENZIME PËR PERSONELIN	23
24. SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE.....	23
25. FITIM/HUMBJE NETO NGA KURSET E KËMBIMIT	23
26. SHPENZIME DHE TË ARDHURA FINANCIARE, NETO	23
27. TATIM FITIMI	24
28. PALËT E LIDHURA	25
29. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR	27
30. RAPORTIMI I VLERËS SË DREJTË	31
31. ANGAZHIME DHE DETYRIMET E KUSHTËZUARA	31
32. NGJARJET PAS DATËS SË BILANCIT.....	31

Pasqyra e pozicionit financiar
Më 31 dhjetor 2014

AKTIVE	Shënime	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
		LEK	LEK
Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	7	6,531,627,394	6,674,701,362
Shpenzime te periudhave te ardhshme		396,082,461	-
Total - Aktive aftagjata		6,927,709,855	6,674,701,362
Aktive aftashkurtra			
Aktiv tatimor i shtyrë	8	13,242,024	12,084,368
Inventari		448,696	1,469,414
Të tjera të arkëtueshme	9	59,355,662	47,982,558
Të drejta tatimore dhe të tjera	10	20,892	135,113
Parapagime të dhëna	11	31,848,494	1,419,104
Te ardhura te shtyra	12	8,943,803	4,876,171
Mjete monetare dhe të ngjashme	13	176,434,842	35,452,632
Total - Aktive afatshkurtra		290,294,413	103,419,360
TOTAL AKTIVE		7,218,004,268	6,778,120,722
KAPITALI DHE DETYRIMET			
Kapitali aksionar	15	3,353,338,000	3,353,338,000
Humbje e akumuluar		(258,824,363)	(236,326,344)
Total – Kapitali		3,094,513,637	3,117,011,656
Detyrime afatgjata			
Huatë nga institucionet financiare	14	3,388,914,673	2,862,296,263
Parapagime të marra	18	19,932,635	24,274,400
Total - Detyrime afatgjata		3,408,847,308	2,886,570,663
Detyrime afatshkurtra			
Huatë nga institucionet financiare	14	390,387,279	447,909,367
Furnitorë dhe të tjera detyrime	17	295,892,887	319,535,759
Parapagime te marra		26,394,657	-
Detyrime tatimore	16	1,968,500	7,093,277
Total - Detyrime afatshkurtra		714,643,323	774,538,403
Total - Detyrime		4,123,490,631	3,661,109,066
TOTAL KAPITALI DHE DETYRIMET		7,218,004,268	6,778,120,722

Këto pasqyra financiare, dhe shënimet shoqëruese 1 deri në 32, janë pjesë e rëndësishme e këtyre pasqyrave financiare, të cilat janë miratuar dhe nënshkruar nga drejtimi më date 27 mars 2015 nga:

Mariola RADOVANI


Drejtore e përgjithshme

Nertila SHATRO


Drejtore e departamentit të financës

TIRANA EAST GATE SH.P.K.
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

Pasqyra përmbledhëse e të ardhurave gjithëpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

Shënime	Viti mbyllur më		
	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013	
	LEK	LEK	
Të ardhura nga Shërbimet	19	905,644,140	823,695,661
Të ardhura te tjera	20	2,104,510	531,108
Totali të ardhura		907,748,650	824,226,769
Shërbime	21	(100,956,444)	(103,366,618)
Shpenzime operative	22	(118,849,441)	(116,794,776)
Zhvleresime per borxhin e keq		(14,256,365)	(21,683,282)
Shpenzime për personelin	23	(4,970,804)	(4,094,668)
Amortizimi	7	(293,855,898)	(299,314,164)
Të tjera shpenzime operative	24	(63,846,679)	(54,849,121)
Humbje nga kursi i këmbimit, neto	25	1,283,997	(15,330,765)
Të ardhura financiare		25,873	74,161
Shpenzime financiare	26	(335,978,564)	(279,926,277)
Të ardhura / shpenzime financiare, neto		-	-
Totali shpenzime operacionale		(931,404,325)	(895,285,510)
Humbja para tatimit		(23,655,675)	(71,058,741)
Tatimi mbi fitimin	27	-	(109,108)
Tatim fitimi I shtyre	8,27	1,157,656	(5,100,848)
Humbja neto per periudhen		(22,498,019)	(76,268,697)
Të tjera të ardhura gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i humbjeve gjithëpërfshirëse		(22,498,019)	(76,268,697)

Monirë Popovani

Arutilla Shatro

Shënimet shoqëruese nga 1 në 32 të pasqyrave financiare janë pjesë e rëndësishme e këtyre pasqyrave financiare.

TIRANA EAST GATE SH.P.K.
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

Pasqyra e ndryshimeve në kapital
Më 31 dhjetor 2014

	Kapital i nënshkruar		Humbje e akumuluar		Totali
	LEK	LEK	LEK	LEK	
Gjendja më 1 janar 2013	3,353,338,000		(160,057,647)		3,193,280,353
Humbje e vitit	-		(76,268,697)		(76,268,697)
Të ardhura përmbledhëse të tjera	-		-		-
Totali i të ardhura përmbledhëse			(76,268,697)		(76,268,697)
Rritje ne kapitalin e nënshkruar	-		-		-
Gjendja më 31 dhjetor 2013	3,353,338,000		(236,326,344)		3,117,011,656
Humbje e vitit	-		(22,498,019)		(22,498,019)
Të ardhura përmbledhëse të tjera	-		-		-
Totali i të ardhura përmbledhëse			(22,498,019)		(22,498,019)
Rritje ne kapitalin e nënshkruar	-		-		-
Gjendja më 31 dhjetor 2014	3,353,338,000		(258,824,363)		3,094,513,637

Shënimet shoqëruese nga 1 në 32 të pasqyrave financiare janë pjesë e rëndësishme e këtyre pasqyrave financiare.

Charles Fedrani

Deetila Shatus

TIRANA EAST GATE SH.P.K.
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

Shënime	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2014 LEK	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2013 LEK
Aktivitetet e shfrytëzimit		
Humbja pas tatimit	(23,655,675)	(71,167,919)
Rregullime për të rakorduar humbjen neto me fluksin neto të parasë		
Amortizime dhe zhvlerësime	7 293,855,898	299,314,158
Shpenzimet neto nga interesat	26 335,952,691	279,926,319
Efekti neto nga ndryshimet në këmbimet valutore	25 (1,283,997)	15,330,810
Zhvlerësime për borxhin e keq	9 14,256,365	21,683,217
Rregullime per kapitalin qarkullues:		
Zbritje/(Rritje) në inventare	1,020,718	(77,112)
(Rritje)/Zbritje në llogari të arkëtueshme	9 (25,425,198)	4,077,202
(Rritje)/Zbritje në parapagime dhe te arkëtueshme të tjera	(426,404,005)	20,829,711
Rritje në të ardhura të shtyra	12 (4,067,632)	(101,443)
Zbritje në llogari të pagueshme	17 (3,236,619)	(20,210,171)
Zbritje në parapagime të marra	18 (4,341,765)	(13,206,873)
Mjetet monetare të përfituara nga aktivitetet e shfrytëzimit	156,670,781	536,397,899
Interes i arkëtuar	26 25,873	9,792,343
Interes i paguar	(176,436,230)	(223,556,797)
Mjetet monetare neto të (përdorura)/përfituara nga aktivitetet e shfrytëzimit	(19,739,576)	322,633,445
Aktivitetet e investimit		
Blerje aktiveve afatgjata materiale	7 (151,297,344)	(109,147,545)
Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	7 515,415	-
Mjetet monetare neto të përdorura në aktivitetet investuese	(150,781,929)	(109,147,545)
Aktivitetet financiare		
Të ardhura nga huamarrje të reja	14 670,286,562	102,475,322
Shlyerje huamarrjeje	14 (359,865,697)	(392,109,881)
Mjetet monetare neto të përfituara/(përdorura) në aktivitetet financiare	310,420,865	(289,634,559)
Rritja/(rënia) neto e mjeteve monetare	139,899,360	(76,148,659)
Efekti i kursit të këmbimit	1,082,850	38,019
Mjetet monetare në fillim të periudhës	35,452,632	111,563,272
Mjetet monetare në fund të periudhës	176,434,842	35,452,632

Shënimet shoqëruese nga 1 në 32 të pasqyrave financiare janë pjesë e rëndësishme e këtyre pasqyrave financiare.

Armando Kodra

Antoni Shatri

1. Informacion i përgjithshëm

Tirana East Gate Sh.p.k. është një shoqëri e themeluar në 21 Tetor 2008 sipas ligjeve të Shqipërisë, si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me ortak të vetëm dhe kryesor Mane TCI me 100% të kapitalit të paguar të shoqërisë. Vlera fillestare e kapitalit ishte 100,000 Lek. Mane TCI sh.p.k. është një shoqëri lider në Shqipëri në tregun e zhvillimit dhe investimin në pasuri të paluajtshme, e cila është pronë e Z. Samir Mane nëpërmjet shoqërisë private BALFIN sh.p.k.

Qëllimi kryesor i shoqërisë është të investojë në ndërtimin e një qendre të re tregtare, e quajtur Qendra Tregtare Tirana East Gate dhe e lokalizuar në Lundër, Tiranë ("Projekti"). Kosto e projektit është përditësuar dhe vlerësuar së fundmi në shumën prej 52,56 million Euro. Projekti përfshin zhvillimin, marrjen me qera si dhe menaxhimin e një qendre argëtuese e tregtare duke prezantuar marka ndërkombëtare në tregun shqiptar. Është parashikuar se projekti do të përfshijë një sipërfaqe totale prej 40,294 m2.

Në Qershor 2009 shoqëria dhe Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) kanë nënshkruar dy marrëveshje huaje për financimin e projektit. Në Mars të 2012, shoqëria dhe entiteti gjerman Deutsche Investitions-Und Entwicklungsgesellschaft MBH (DEG) hynë në marrëveshje huaje për të financuar pjesën e mbetur të projektit. Këto marrëveshje u ndryshuan më pas më 15 Mars 2010.

Në këto marrëveshje është përcaktuar struktura e financimit të projektit, si më poshtë:

Kapitali	25,350,000 EUR
Huaja kryesore –DEG	10,000,000 EUR
Huaja mezanine –EBRD	7,000,000 EUR
Huaja kryesore – EBRD	10,000,000 EUR
Hua nga ortaku- Mane TCI	211,778 EUR
Totali	52,561,778 EUR

Në mënyrë që të arrihet niveli i kërkuar i kapitalit, Mane TCI kërkoi për partnerë të tjerë për t'iu bashkëngjitur projektit. Në gusht 2009 AAEF – Albanian American Enterprise Fund u bashkua si një aksionar me 8.095% të kapitalit total aksionar. Në 2013 Mane TCI i shiti 3% të kapitalit aksionar kundrejt kompanisë First Investment Services.

Fondet e kapitalit janë paguar totalisht dhe u përdorën në përputhje me buxhetin e investimit të rënë dakort nga të gjithë partnerët në projekt.

Deri më 31 Dhjetor të 2014 administrator i shoqërisë është Zj. Mariola Radovani.

Më 31 Dhjetor 2014 shoqëria ka të punësuar 3 punonjës (31 Dhjetor 2013: 3 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"), të publikuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve Kontabël ("IASB").

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

Pasqyrat financiare të shoqërisë janë përgatitur në Lek shqiptar ("Lekë"), e cila është edhe monedha funksionale e shoqërisë si rrjedhojë e mjedisit ekonomik ku operon shoqëria, ku të gjitha vlerat janë rumbullakosur me vlerën e tyre nominale, përveç aty ku shprehemi ndryshe.

Kompesimi (netimi)

Aktivitetet dhe detyrimet financiare janë të kompensuara me njëra tjetrën dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm nëqoftëse është ligjërisht e detyrueshme për të kompensuar shumën e njohur dhe ka si qëllim të mos fshehi bazën neto, ose të realizosh aktive dhe të fshish detyrimet njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet nuk lejohen të kompensohen në pasqyrën përmbledhëse e të ardhurave, vetëm nëse lejohet ose kërkohet nga interpretimet e standardeve kontabël, si dhe në shënime shpjeguese të parimeve kontabël të entitetit.

3. Ndryshimet në politikat kontabël dhe shpjegimet

Standarte te reja dhe te rishikuara

Politikat kontabël të adoptuara janë konsistente me politikat e vitit të mëparshëm me përjashtim të SNRF-ve të ndryshuara, të cilat janë adoptuar nga Shoqëria në datën 1 janar 2014.

- **SNK 32 Instrumentet Financiare, Paraqitja (Ndryshuar) – Kompensimi i Aktiveve Financiare dhe Detyrimeve Financiare**
- **SNK 39 Instrumentet financiare (Ndryshuar): Njohja dhe Matja - Zëvendësimi i Derivativeve dhe Vijimesia e Kontabilitetit Mbrojtjes**
- **SNK 36 Zhvlerësimi Aktiveve (Ndryshuar) – Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Shumat e Rikuperueshme të Aktiveve jo – financiare**
- **KIRFN Interpretimi 21: Taksat**

Pershtatja me standardet dhe interpretimet pershkruhet me poshte.

• SNK 32 Instrumentet Financiare, Paraqitja (Ndryshuar) – Kompensimi i Aktiveve Financiare dhe Detyrimeve Financiare

Këto ndryshime sqarojnë kuptimin e frazes: "aktualisht ka një të drejtë të zbatueshme ligjore për kompensim". Ndryshimet sqarojnë gjithashtu zbatimin e SNK 32 Kriteret e Kompensimit për Sistemet e Shlyerjes (si për shembull sistemet e institucioneve qendrore te kleringut), të cilët zbatojnë mekanizma të shlyerjes bruto, që nuk janë të njëpasnjëshme. Nuk ka asnje efekt ne pasqyrat financiare te shoqerise nga aplikimi i ndryshimeve te mesiperme.

• SNK 39 Instrumentet Financiare (Ndryshuar): Njohja dhe Matja - Zëvendësimi i Derivativeve dhe Vijimesia i Kontabilitetit Mbrojtjes

Ndryshimi parashikon se nuk do të ishte e nevojshme që të skontohej kontabiliteti mbrojtjes nëse një derivativ mbrojtje zëvendësohet, me kusht që të plotësohen disa kriteret. Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) ka bërë një ndryshim te ngushte objektit te SNK 39, për të lejuar vazhdimin e kontabilitetit mbrojtjes në disa rrethana të caktuara ku pala tjetër e instrumentit mbrojtje ndryshon, në mënyrë për të arritur likuidimin për atë instrument. Nuk ka asnje efekt ne pasqyrat financiare te shoqerise nga aplikimi i ndryshimeve te mesiperme.

• SNK 36 Zhvlerësimi Aktiveve (Ndryshuar) – Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Shumat e Rikuperueshme të Aktiveve Jo – Financiare

Këto ndryshime heqin pasojat e paqëllimshme të SNRF 13 mbi dhënien e informacioneve shpjeguese, që kërkohen sipas SNK 36. Përveç kësaj, këto ndryshime kërkojnë dhënien e informacioneve shpjeguese të shumave të rikuperueshme për aktivet apo Njësitë Gjeneruese të Mjeteve Monetare (CGUs), për të cilën zhvlerësimi është njohur apo është rimarë gjatë periudhës. Nuk ka asnje efekt ne pasqyrat financiare te shoqerise nga aplikimi i ndryshimeve te mesiperme.

• KIRFN Interpretimi 21: TAKSA

Komitetit të Interpretimeve i është kërkuar të marrë në konsideratë se si një entitet duhet të përgjigjet për detyrimet për të paguar taksat e vendosura nga qeveritë, përveç taksat mbi të ardhurat, në pasqyrat e saj financiare. Ky Interpretim është një interpretim i SNK 37 Provizionet, Pasivet dhe Aktivet e Kushtëzuara. SNK 37 përcakton kriteret për njohjen e një pasivi, një prej të cilave është kërkesa që entiteti të ketë një detyrim aktual, si rezultat i një ngjarjeje të mëparshme (e njohur si një ngjarje detyruese). Interpretimi sqaron se ngjarja detyruese që shkakton një detyrim për të paguar një taksë është aktiviteti i përshkruar në legjislacionin përkatës që shkakton pagesën e taksës. Nuk ka asnje efekt ne pasqyrat financiare te shoqerise nga aplikimi i ndryshimeve te mesiperme.

4. Gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon gjykime dhe vlerësime që ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në raportimin e vlerave të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe të shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara nga shoqëria.

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar vazhdimisht. Ndryshime ne çmuarjet dhe vlerësimet kontabile njihen ne periudhen ne te cilen çmuarjet ndryshojne, dhe ne periudhat e ardhshme qe mund te preken nga ky ndryshim. Informacioni mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimet mbi aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare janë të paraqitura më poshtë.

4. Gjykime të rëndësishme kontabël, çmuarjet dhe vlerësimet (vazhdim)

Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Është i nevojshëm gjykimi për përcaktimin e shumës së tatimit mbi fitimin aktual dhe atyre të shtyra. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar tatimor është i pasigurt. Shoqëria njihet detyrimin në rast të auditimit të pritur tatimor bazuar në vlerësimet se taksa shtesë do mund të lindin si detyrim. Nëse tatimi përfundimtar do jete i ndryshëm nga shumata që ishin regjistruar fillimisht, diferencat do e ndikojë në vlerën aktuale të aktiveve tatimore të shtyra dhe pasiveve në periudhën në të cilën një përcaktim i tillë është bërë.

Aktivi tatimor i shtyrë njihet për humbjet tatimore të papërdorura deri në atë masë që është e mundshme që do të kete fitim të tatueshëm, do të jetë i disponueshëm dhe kundrejt të cilit mund të shfrytëzohen humbjet. Është i nevojshëm gjykimi nga menxhimi për të përcaktuar shumën e aktiveve tatimore të shtyra që mund të njihen, bazuar mbi kohën e mundshme dhe nivelin e fitimit të tatueshëm prishem, së bashku me strategjitë për planifikimin tatimor.

Rishikimi i zhvlerësimit

Rikuperimi i aktiveve është një ceshtje që kërkon gjykim të menaxhimit, që kërkon vlerësim nëse vlera kontabël e aktiveve mund të mbështetet në vlerën neto aktuale të flukseve monetare të ardhshme që pritet të gjenerohen nga përdorimi i aktiveve të tilla duke përdorur parashikimet e flukseve monetare të cilat janë skontuar me një normë të përshtatshme. Në llogaritjen e vlerës aktuale neto të flukseve monetare të ardhshme, janë të nevojshme supozime në lidhje me çështjet të pasigurta, siç përmendet më poshtë.

Standardet SNRF kërkojnë që menaxhimi të kryejë teste vjetore për zhvlerësimin e aktiveve dhe përcaktimin e jetes se tyre, gjithashtu kërkohet dhe vlerësimi i situatave të mundshme që do të sillnin mosrikuperimin e vlerës së aktiveve. Shoqëria ka kryer një plan shtatë-vjecar financiar, ku supozimet kryesore ishin norma e qiradhenies (në bazë të kontratave të qirasë aktuale), rritja vjetore në përqindjen e sipërfaqes se dhene me qera, reduktim potencial të uljeve akorduar qeramarsve dhe të gjitha kostot e tjera financiare dhe kosto amortizimi të cilat bazohen në informacionin aktual në dispozicion për qendren. Bazuar në informacionin e disponueshëm dhe testimet, shoqëria ka arritur në përfundimin se nuk ka indikacione për zhvlerësim të aktiveve në 31 Dhjetor 2014.

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të përshkruara më poshtë janë zbatuar në mënyrë konsistente përgjatë gjithë periudhave të paraqitura në pasqyrat financiare dhe janë zbatuar në mënyrë konsistente nga shoqëria.

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Regjistrimet kontabël të shoqërisë janë paraqitur në monedhën vendase "Lek", e cila është monedha kryesore e mjedisit ekonomik në të cilën operon shoqëria.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, transaksionet në monedhë tjetër nga monedha funksionale (monedha të huaja) regjistrohen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Në fund të çdo periudhe raportuese, mjetet monetare në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin e datës së raportimit. Mjetet jo monetare që mbahen me vlerë të drejtë regjistrohen në monedhë të huaj dhe rivlerësohen në kursin e datës kur përcaktohet vlera e drejtë. Mjetet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj nuk rivlerësohen.

Diferencat nga këmbimi njihen si fitim apo humbje në pasqyrën përmbledhëse e të ardhurave në periudhën në të cilën ndodhin, duke përjashtuar diferencat nga këmbimi në huamarrjen në monedhë të huaj të lidhura me aktivet në ndërtim, për përdorim frytëdhënës në të ardhmen, të cilat janë përfshirë në kostot e aktiveve si një rregullim të koston së interesit në huamarrjen në monedhë të huaj.

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(a) Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)

Transaksionet e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përkthyer me kursin mesatar të këmbimit për secilën periudhë, përveç rasteve të luhatshmërisë të ndjeshme të kursit të këmbimit, nese ka, të cilat do të paraqiten me kursin e këmbimit të datës që ndodh transaksioni.

(b) Instrumentat financiarë

Shoqëria fillimisht i ka njohur llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat ne datën e krijimit të tyre. Të gjitha të drejtat e tjera financiare (duke përfshirë edhe aktivet e vlerësuar me vlerën e drejtë) njihen në datën e tregtimit, datën kur Shoqëria ka lidhur një kontratë për këto instrumenta. Shoqëria ç'regjistron një aktiv në momentin kur të drejtat kontraktuale për flukset e të ardhurave skadojnë, ose kur të gjitha të drejtat për të përfituar flukset kontraktuale të të ardhurave transferohen me anë të një transaksioni, i cili transferon përfitimet dhe risqet që lidhen me pronësinë e aktivitetit. Ndonjë interes që është mbajtur apo krijuar mbi aktivet e transferuara, paraqitet më vete si një e drejtë apo detyrim.

Një detyrim financiar ç'regjistrohet kur detyrimi shlyhet, mbyllet ose përfundon afati i tij. Kur një detyrim financiar ekzistues zëvendësohet me kushte të ndryshme nga një tjetër po nga i njëjti kontraktor ose kushtet e detyrimit ekzistues modifikohen ndjeshëm, atëherë ai do të trajtohet si ç'regjistrim i detyrimit aktual dhe njihes së një detyrimi të ri. Diferenca nga kryerja e transaksionit do të njihen në pasqyrën e të ardhurave.

Detyrimet dhe të drejtat financiare netohen dhe paraqiten me vlerën neto në bilanc, vetëm kur Shoqëria ka të drejtën ligjore për të netuar vlerat dhe ka për qëllim të shlyejë këto neto, apo të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Instrumentat jo derivativë të Shoqërisë përfshijnë të tregëtueshmet dhe llogaritë e arkëtueshme, paraja dhe ekuivalentët e saj, të tregëtueshmet dhe llogaritë e pagueshme të tjera.

Paraja dhe ekuivalentë të saj

Paraja dhe ekuivalentë të saj përfshin para në arkë dhe llogaritë rrjedhëse bankare. Për qëllime të përgatitjes së pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentë të saj përfshijnë para dhe depozita afatshkurtra të përcaktuara si neto nga overdrafti i pashlyer në bankë.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit minus humbjet nga zhvlerësimi.

Huatë nga Institucionet financiare

Huatë e marra nga institucionet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë, duke zbritur koston e transaksionit. Detyrimet financiare maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke njohur shpenzimin e interesit mbi bazën e interesit efektiv.

Metoda e normës efektive të interesit është një metodë llogaritje për koston e amortizuar të një detyrimi financiar dhe e alokimit të shpenzimit të interesit përgjatë periudhës. Norma efektive e interesit është norma e cila skanton ekzakhtësisht pagesat e ardhshme të vlerësuar përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose, ku është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

Të tjera

Instrumenta të tjerë financiarë jo-derivativ vlerësohen me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv minus humbjet nga zhvlerësimi.

(c) Aktive afatgjata të investimit

Aktivi afatgjata i investimit, i cila është një pronë e mbajtur për të marrë të ardhura në formë monetare dhe/ose për rivlerësime kapitale (duke përfshirë edhe prona për ndërtim për qëllime të tilla), vlerësohen fillimisht me kosto duke përfshirë edhe kostot e transaksionit. Fillimisht njihen në pasqyrën e pozicionit financiar kur risqet dhe përfitimet e pronësisë i janë transferuar shoqërisë pavarësisht nëse titulli i pronësisë i është transferuar asaj. Prona për investim fillimisht njihen me koston e tyre. Në vazhdim, prona për investim njihen duke përdorur modelin e koston.

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(d) Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Aktivet afatgjata materiale, maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të ndërtaura nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e caktuar, kostot e çmontimit dhe lëvizjen e aktiveve të ndryshme dhe kthimin e vendodhjes së tyre në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot e kapitalizuara të huave. Kostot gjithashtu mund të përfshijnë zëra të transferuar nga të ardhurat përmbledhëse të tjera në lidhje me fitime apo humbje të flukseve të parasë të kualifikuara nga mbulimi për blerjen e pronave dhe paisjeve. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë përbërëse të funksionalitetit të paisjeve përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj paisjeje.

Në momentin që një nga aktivet afatgjata materiale përbëhet nga pjesë me jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato regjistrohen si pjesë të ndara nga njëra tjetra. Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve materiale përcaktohen duke krahasuar arkëtimet nga shitja me vlerën kontabël neto të aktivit dhe njihet neto në të ardhura ose humbje të tjera.

Kostot në vijim

Kostot për zëvendësimin e një aktivi regjistrohen me vlerën kontabël të aktivit në rast së është e mundur që përfitimet ekonomike në periudhat e ardhshme të përfshira në të, të mund të rrjedhin tek shoqëria dhe kostoja të mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël e pjesëve të ndërruara si rrjedhojë ç'rrregjistrohet. Kostoja e shërbimit ditor, të vazhdueshëm të ndërtesave dhe paisjeve regjistrohet tek fitimet ose humbjet kur ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi vlerën e amortizueshme e cila është kostoja e aktivit ose cdo kosto tjetër zëvendësuese minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në pasqyrën përmbledhëse e të ardhurave bazuar në metodën e vlerës së mbetur për paisjet e zyrës me një normë amortizimi vjetore prej 20%, për paisjet informatike 25% dhe për makinat e transportit 20%. Kjo mënyrë pasqyron më përfaqësisht trendin e konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike të përfshira në këto aktive.

Përmirësimet e aktiveve të marra me qera amortizohen mbi 20 vjet. Aktivet në proces nuk amortizohen.

Normat e amortizimit dhe vlerat e mbetura, nëse janë të rëndësishme, aktivet afatgjata materiale rivlerësohen në datën e raportimit.

(e) Aktivet afatgjata jomateriale

Njohja dhe matja

Aktivet jomateriale të blera nga shoqëria maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimin në vlerë të akumuluar.

Kostot në vijim

Kostot në vijim kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike nga aktivi specifik me të cilat lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera, duke përfshirë shpenzimet e gjenerimit të emrit të mirë dhe markës, njihen në pasqyrën përmbledhëse e të ardhurave (në humbje ose fitime) në momentin e ndodhjes.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi koston e aktiveve, ose cdo vlerë tjetër të konsideruar si kosto, minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në të ardhura ose shpenzime duke përdorur metodën e vlerës së mbetur me një norme vjetore amortizimi 25%.

(f) Zhvlerësimet e aktiveve

Aktivet financiare

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna objektive që ka pësuar rënie në vlerë. Një aktiv financiar bie në vlerë nëse ka të dhëna objektive të një ngjarje që ka çuar në zhvlerësimin e tij pas momentit fillestar të njohjes së aktivit, dhe kjo ngjarje ka efekt negativ në flukset e vlerësuar në të ardhmen nga aktivi të cilat mund të maten me besueshmëri.

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(f) Zhvlerësimet e aktiveve (vazhdim)

Humbja nga rënia në vlerë e aktivitetit të vlerësuar me koston e amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme që priten të gjenerohen nga ky aktiv financiar i skontuar me normën fillestare efektive të interesit. Humbjet njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave (në humbje ose fitim). Interesi nga aktivitetet e zhvlerësuar në këtë mënyrë vazhdon të njihet nëpërmjet amortizimit të skontos. Kur një ngjarje pasuese shkakton zvogëlimin e rënies në vlerë, shumat përkatëse rimerret nëpërmjet pasqyrës përmbledhëse të të ardhurave.

Aktivitet jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo financiare të shoqërisë rishikohet në datën e raportimit për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dhënë për rënie në vlerë. Nëse ekziston ndonjë evidencë e tillë për rënie në vlerë atëherë matet vlera e rikupercrueshme e aktivitetit. Vlera e rikuperueshme është vlera më e madhe midis vlerës së drejtë minus koston e shitjes dhe vlerës në përdorim. Gjatë vlerësimit të vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të vlerësuar skontohen për të arritur në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqeve specifike të aktiveve që nuk janë marrë parasysh në vlerësimin e flukseve të ardhshme.

Një humbje nga rënia e vlerës njihet nëse vlera kontabël e aktivitetit tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën përmbledhëse e të ardhurave.

(g) Përfitimet e punonjësve

Kontributet e sigurimeve shoqërore

Gjatë ecurisë normale të biznesit, shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet shoqërore, të cilat janë të detyrueshme bazuar në legjislacionin vendas. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin e ndodhjes.

(h) Provigjonet

Një provigjon njihet kur, si pasojë e ngjarjeve të kaluara, shoqëria ka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive të cilat mund të vlerësohen me vërtetësi, dhe ka mundësi që të ketë nxjerrje të flukseve të ardhshme të parasë për të shlyer këtë detyrim. Provigjonet përcaktohen si aktualizimi i flukseve të pritshme me një normë takse që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të parasë dhe rrezikut specifik të detyrimeve.

(i) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë flukset neto të përfitimve ekonomike gjatë periudhës të cilat gjenerohen përgjatë ecurisë normale të aktiviteteve të biznesit.

Të ardhurat nga qeraja

Të ardhurat nga qeraja janë të drejta që i lindin shoqërisë nga qeratat operative, duke përfshirë të ardhurat nga qera të ndara, të cilat njihen kur ato plotësohen. Kostot fillestare direkte që ndodhin në momentin e negociimit të një kontrate qeraje operative, njihen si shpenzim gjatë kohëzgjatjes së qerasë, në të njëjtën mënyrë si të ardhurat nga qeraja.

Kushtet lehtësuese të një marrëveshje qeraje janë të përcaktuara në termat e qerasë, dhe shpërndahen gjatë afatit të qerasë, edhe nëse pagesat nuk janë kryer mbi këtë bazë. Termat e qerasë janë të pa kthyeshme gjatë kohëzgjatjes së qerasë së bashku me cdo term tjetër, deri në momentin ku qeramarrësi ka opsionin për të vazhduar qeranë, dhe drejtuesit janë të qartë që qeramarrësi do ta ushtrojë këtë opsion.

Shuma e përfutur nga qeramarrësi për të përfunduar marrëveshjen e qerasë njihen në pasqyrën e të ardhurave kur lind e drejta e përfitimt të tyre.

Bonusi për hyrjen e qeramarrësve

Sic kerkohet nga Komiteti i Interpretimit të Standardeve 15 – Qirate operationale dhe stimujt e dhene (SIC 15) bonuset për hyrjen e qeramarrësit në ambientet e qendrës tregtare të Shoqërisë, apo shpërblime të tjera të ngjashme, njihen si pjesë integrale e pagesës neto që është rënë dakort midis palëve për përdorimin e ambienteve të lëshuara me qera, përgjatë afatit të kontratës së qerasë, pavarësisht natyrës, formës apo kohës kur kryhet pagesa.

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(i) Njohja e të ardhurave (vazhdim)

Qeradhënësi njihet si koston agregate të bonusit përkatës si zbritje të të ardhurave nga qeraja përgjatë kohëzgjatjes së kontratës, sipas metodës lineare, në mos një metodë tjetër sistematike është më përfaqësuese për periudhën kohore përgjatë të cilës shtrihet përfitimi prej aktivitetit të lëshuar me qera.

(j) Pagesat e qerasë

Qeratë klasifikohen si qera financiare kur kushtet e qerasë transferojnë në mënyrë domethënëse të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësisë tek qeramarrësi. Të gjitha qeratë e tjera klasifikohen si qera operative. Pagesat e bëra për qeranë operative janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave në bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës. Shoqëria ka hyrë në marrëveshje qeraje për prona tregtare, dhe ka përcaktuar, bazuar në vlerësimet kushtet e marrëveshjes, ku zotëron të gjitha risqet dhe përfitimet mbi këto prona dhe për këtë arsye i konsideron ato si qera operative.

Shoqëria si qeramarrëse

Qeratë financiare që transferojnë rrezikun dhe përfitimet në mënyrë aksidentale tek shoqëria, janë kapitalizuar si një fillim i ri i qerasë me vlerën e drejtë të pronës së dhënë me qera, ose nëqoftëse është më e vogël me vlerën aktuale të minimumit të pagesave të qerasë. Pagesat e qerasë janë të ndarë midis pagesave financiare dhe uljes së detyrimit ndaj qerasë, për të arritur në një nivel konstant të interesit në tepriçen e mbetur të detyrimit. Pagesat financiare janë njohur si kosto financiare në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një aktiv i dhënë me qera është amortizuar gjatë jetës së dobishme të tij. Megjithatë, meqenëse shoqëria nuk ka një siguri që do të zotërojë pronësinë në fund të kohëzgjatjes së qerasë, aktiviteti do të amortizohet për një periudhë më të vogël se jeta e dobishme e tij. Pagesat e qerasë operative janë njohur si shpenzime operative në pasqyrën e të ardhurave në mënyrë lineare gjatë kohëzgjatjes së qerasë.

Më 31 Dhjetor 2014, shoqëria nuk ka qera financiare dhe operative duke vepruar si qeramarrës.

Shoqëria si qeradhënëse.

Qeratë ku shoqëria nuk transferon konsiderueshëm risqet dhe përfitimet e pronësisë të një aktiviteti janë klasifikuar si qera operative. Kostot direkte fillestare të ndodhura për pershtatjen e ambienteve sipas kërkeses së qeramarrësit të një qeraje operative i shtohen shumës së aktivitetit të dhënë me qera dhe njihen në të njëjtën bazë si të ardhura nga qeraja. Qeratë e ndara do të njihen si të ardhura në periudhën në të cilën ato janë përfituar, në mënyrë lineare gjatë kohëzgjatjes së qerasë.

Depozitimet e qeramarrësit

Detyrimet për depozitim të qeramarrësit njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe në vazhdim me koston e amortizuar kur ka vlerë materiale. Cdo diferencë midis vlerës së drejtë fillestare dhe vlerës nominale përfshihet si një e ardhur komponent të qerasë operative dhe njihen në mënyrë lineare përgjatë gjithë termave të qerasë.

(k) Të ardhurat dhe kostot financiare

Të ardhurat financiare përbëhen nga të ardhurat nga interesi për fondet e investuara në depozita bankare dhe nga të ardhurat nga këmbimi.

Kostot financiare përbëhen nga shpenzimet e interesit të huave, shpenzime nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare në fitim dhe humbje, dhe nga rënia në vlerë e aktiveve financiare. Humbjet apo fitimet nga kursi i këmbimit janë paraqitur në vlerë neto.

(l) Kostot e huave

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve, të cilat duan një kohë të gjatë për tu sjellë në formë përfundimtare, në mënyrë që të përdoren apo shiten, i shtohen kostos së këtyre aktiveve, deri në momentin kur këto aktive janë gati që qëllimin e tyre për përdorim ose për shitje.

Të ardhurat nga investimet e përkohshme, për sa i përket disa huave të veçanta, të cilave ende nuk ju është paguar interesi, kjo shumë ju zbritet kostove të huamarrjes dhe nuk i kapitalizohet koston së aktivitetit.

Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(m) Shpenzime për tatim fitimin

Tatimi mbi fitimin nënkupton tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhen me zëra të njohur direkt në kapital, në të cilat rregjistrohen direkt në kapital. Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi fitimin e tatueshem për vitin, duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, duke paraqitur për diferencat e përkohshme midis vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të kthehen, bazuar në ligjet që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit. Një aktiv i tatimit të shtyrë njihet nëse është e mundshme që të ardhura të tatueshme do të realizohen kundrejt të cilave diferencat e përkohshme mund të përdoren. Aktivet e tatimit të shtyrë rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa nuk janë më të mundshme që përfitimet tatimore të lidhura me të do të realizohen.

(n) Kapitali aksioner

Kapitali aksioner i shoqërisë është i njohur me vlerë nominale. Aksionet e zakonshme të shoqërisë klasifikohet si kapital.

6. Standarde të publikuara por jo ende të zbatuara

Një numër standardesh të reja, amendamente të standardeve dhe interpretime janë efektive gjatë fillimit të periudhës 1 Janar 2014, dhe nuk janë zbatuar në pasqyrat financiare vjetore aktuale.

- **SNK 16 Aktive Afatgjata Materiale dhe dhe SNK 38 Aktivët jo-Materiale (Ndryshimi): Quartësimi i Metodave të Pranueshme të Zhvlerësimit dhe Amortizimit** (efektive për periudha vjetore më dhe pas 1 Janar 2016)
- **SNK 19 Përfitimet e Punonjësve (Ndryshuar): Kontributet e Punonjësve** (efektive për periudha vjetore më dhe pas 1 shkurt 2015)
- **SNRF 9 Instrumentet Financiare - Klasifikimi dhe matja** (efektive për periudha vjetore më dhe pas 1 janar 2018)
- **SNRF 11 Marrëveshjet e përbashkëta (Ndryshimi): Kontabiliteti i Marrjes së Interesave në Operacione të Përbashkëta** (efektive për periudha vjetore më dhe pas 1 janar 2016)
- **SNRF 14 Llogaritë e Shtyra për Efekte Rregullatore** (efektive për periudha vjetore më dhe pas 1 janar 2016)
- **SNRF 15 Të ardhurat nga Kontratat me Klientët** (efektive për periudha vjetore më dhe pas 1 janar 2017)
- **SNK 27 Pasqyrat Financiare Individuale (Ndryshuar)** (efektive për periudha vjetore më dhe pas 1 janar 2016)
- **Ndryshimi në IFRS 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe SNK 28 Investime në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta: Shitja apo Kontributi i Aktiveve ndërmjet një Investitori dhe Bashkëpunëtorit apo Sipërmarrjes së tij të Përbashkët** (efektive për periudha vjetore më dhe pas 1 janar 2016)

Përmirësime vjetore 2010 - 2012

BSNK ka publikuar Përmirësimet Vjetore për SNRF-të Ciklit 2010 – 2012, që është një koleksion i ndryshimeve të SNRF-ve. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 shkurt 2015. Drejtimi ka vlerësuar se adoptimi i këtij amendimi nuk do të ketë impakt në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

- **SNRF 2 Pagesat e Bazuara në Aksione:** Ky përmirësim ndryshon përkufizimet “konditat e kushtëzimit” dhe “kushti i tregut” dhe shton përkufizimet “kushti i performancës” dhe “kushti i shërbimit” (që kanë qenë më parë pjesë e përkufizimit “kondita e kushtëzimit”).
- **SNRF 3 Kombinimet e Biznesit:** Ky përmirësim sqaron se Shuma e Kushtezuar në një blerje biznesi që nuk është klasifikuar si kapital matet më pas me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, qoftë kur i përket ose jo objektit të SNRF 9 Instrumentet Financiare.

6. Standarde të publikuara por jo ende zbatuara (vazhdim)

Përmirësime vjetore 2010 – 2012 (vazhdim)

- **SNRF 8 Segmentet e Shfrytëzimit:** Ky përmirësim kërkon që entiteti të zbulojë gjykimet e bëra nga niveli drejtues në zbatimin e kriterëve të bashkimit ndaj segmenteve të shfrytëzimit dhe sqaron se një entitet jep rakordimet e totalit të aktiveve të segmenteve raportuese tek aktivet e entitetit vetëm nëse aktivet e segmentit raportohen rregullisht.
- **SNRF 13 Matja me Vlerën e Drejtë:** Ky përmirësim në Bazat e Përfundimit të SNRF 13 sqaron se publikimi i SNRF 13 dhe ndryshimi i SNRF 9 dhe SNK 39 nuk e ka hequr mundësinë për të matur të kërkesat dhe detyrimet afatshkurtra me asnjë normë të deklaruar interesi, në shumat e tyre të faturave pa skontuar nëse efekti i skontimit nuk është material.
- **SNK 16 Aktivet Afatgjata Materiale:** Ndryshimi sqaron se kur një objekt i aktiveve afatgjata materiale rivlerësohet, vlera kontabël bruto përshtatet në një mënyrë të tillë që të jetë në përputhje me rivlerësimin e vlerës kontabël.
- **SNK 24 Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Palët e Lidhura:** Ndryshimi sqaron se një entitet që siguron shërbime menaxhimi të personelit për entitetin raportues ose të prindit të entitetit raportues është palë e lidhur me entitetin raportues.
- **SNK 38 Aktivet Jo-materiale:** Ndryshimi sqaron se kur rivlerësohet një aktiv jo-material, vlera kontabël bruto përshtatet në një mënyrë të tillë që të jetë në përputhje me rivlerësimin e vlerës kontabël.

Përmirësime vjetore Maj 2011 - 2013

BSNK ka publikuar Përmirësimet Vjetore për SNRF-të Cikli 2011 – 2013, që është një koleksion i ndryshimeve të SNRF-ve. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2015. Drejtimi ka vlerësuar se adoptimi i këtij amendimi nuk do të ketë impakt në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

- **SNRF 3 Kombinimet e Biznesit:** Ky përmirësim sqaron se SNRF 3 përjashton nga objekti i saj kontabilitetin për formimin e një rregullimi të përbashkët në pasqyrat financiare të vetë rregullimit të përbashkët.
- **SNRF 13 Matja me Vlerën e Drejtë:** Ky përmirësim sqaron se qëllimi i përjashtimit të portofolit të përcaktuar në paragrafin 52 të SNRF 13 përfshin të gjitha kontratat e llogaritura brenda objektit të SNK 39 Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja ose SNRF 9 Instrumentet Financiare, pa marrë parasysh nëse ata plotësojnë përkufizimin e aktiveve financiare ose detyrimeve financiare, siç përcaktohet në SNK 32 Instrumentet Financiare: Paraqitja.
- **SNK 40 Aktive Afatgjata Materiale të Investuara:** Ky përmirësim sqaron se përcaktimi nëse një transaksion specifik plotëson përkufizimin e kombinimit të biznesit, siç përcaktohet në SNRF 3 Kombinimet e Biznesit dhe investimet në Aktive Afatgjata Materiale siç përkufizohet në SNK 40 Aktive Afatgjata Materiale të Investuara kërkon aplikim të veçantë të dy standardeve në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri.

Përmirësime vjetore Maj 2012 - 2014

BSNK ka publikuar Përmirësimet Vjetore për SNRF-të Cikli 2012 – 2014, që është një koleksion i ndryshimeve të SNRF-ve. Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2016. Drejtimi ka vlerësuar se adoptimi i këtij amendimi nuk do të ketë impakt në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

- **SNRF 5 Aktive Afatgjata që mbahen për tu shitur dhe Operacionet Jo-të Vijueshme:** Ndryshimi sqaron se ndryshimi nga një prej metodave të shitjes tek tjetra (përmes shitjes apo përmes shpërndarjes tek pronarët) nuk duhet të konsiderohet si një plan i ri shitjeje, por si një vazhdim i planit origjinal. Prandaj nuk ka ndërprerje të zbatimit të kërkesave në SNRF 5. Amendimi gjithashtu sqaron se ndryshimi i metodës së shitjes nuk ndryshon datën e klasifikimit.
- **SNRF 7 Instrumentet Financiare: Dhënia e Informacioneve Shpjeguese:** Ndryshimi sqaron se një kontratë shërbimi që përfshin një tarifë mund të përbëjë përfshirje të vazhdueshme në një aktiv. Gjithashtu, ndryshimi sqaron se SNRF 7 Informacionet Shpjeguese, lidhur me kompensimin e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare, nuk janë të nevojshme në pasqyrat financiare të ndërmjetme.

6. Standarde të publikuara por jo ende zbatuara (vazhdim)

Përmirësime vjetore 2012 – 2014 (vazhdim)

- **SNK 19 Përfitimet e Punonjësve:** Ndryshimi sqaron se thellësia e tregut të obligacioneve me cilësi të lartë të korporatave vlerësohet në bazë të monedhës në të cilën detyrimi është i shprehur, se sa vendi ku detyrimi ndodhet. Kur nuk ka treg të thellë për obligacione me cilësi të lartë të korporatave në atë monedhë, duhet të përdoret raporti i bonove qeveritare.
- **SNK 34 Raportimi Financiar i Ndërmjetëm:** Ndryshimi sqaron se informacionet e kërkuara shpjeguese të përkohshme duhet të jenë ose në pasqyrat financiare të ndërmjetme ose të përfshihen nga referenca ndërmjet pasqyrave financiare të ndërmjetme dhe kudo ku ato përfshihen në raportin më të madh të ndërmjetem financiar (p.sh. në raportin e komenteve për menaxhimin apo risqet).
- **SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 28: Entitetet e investimit: Aplikimi i përjashtimit të Konsolidimit (Ndryshuar).** Ndryshimet i adresohen tri çështjeve që lindin në praktikë në zbatimin e përjashtimit të konsolidimit të entiteteve investuese. Amendimet behen efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2016. Amendimet sqarojnë se përjashtimi i paraqitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara zbatohet për njesite ekonomike mëmë që janë degë e një njesie investimi, kur njesia e investimit vlerëson deget me vlerë të drejtë. Gjithashtu, amendimet sqarojnë se vetëm një degë që nuk është një njesi investimi vetë dhe ofron shërbime mbështetëse për njesinë e investimit konsolidohet. Të gjitha degët e tjera të një njesie ekonomike investuese maten me vlerën e drejtë. Së fundi, ndryshimet e SNK 28 Investimet në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta lejojnë investitorin, në momentin e aplikimit të metodës së kapitalit, për të rikuperuar vlerën e drejtë të aplikuar nga njesia ekonomike investuese ose sipërmarrje e përbashkët sipas interesave të saj në filiale. Drejtimi ka vlerësuar se adoptimi i këtij amendimi nuk do të ketë impakt në pasqyrat financiare të Shoqërisë.
- **IAS 1: Paraqitja e shënimeve shpjeguese (Ndryshuar).** Ndryshimet në SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare inkurajojnë kompanitë për të aplikuar gjykimin profesional në përcaktimin e informacionit për tu paraqitur në pasqyrat financiare si shënime shpjeguese dhe si ta strukturjnë atë në pasqyrat e tyre financiare. Amendimet behen efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2016. Ndryshimet në SNK me shume sqarojnë sesa të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme kërkesat ekzistuese të SNK 1. Ndryshimet kanë të bëjnë me materialitetin, rradhën e shënimeve, sub-totalet dhe ndarjen, politikat kontabël dhe paraqitjen e zërave të të ardhurave të tjera përmbledhëse që rrjedhin nga kontabilizimi i investimeve në kapital. Drejtimi ka vlerësuar se adoptimi i këtij amendimi nuk do të ketë impakt në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

TIRANA EAST GATE SH.P.K.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë shprehur në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

7. Aktive afatgjata materiale

	Toka		Ndertesa & Punime		Pajisje kompjuterike		Mobilje dhe pajisje te tjera		Ne proces		Totali	
	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK
Kosto												
Gjendja me 1 Janar 2013	849,899,273	6,309,864,174	18,638,980	19,091,163								7,197,493,590
Shtesa	-	10,410,529	54,084	1,160,741					97,522,197			109,147,551
Pakesime	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja me 31 Dhjetor 2013	849,899,273	6,320,274,703	18,693,064	20,251,904					97,522,197			7,306,641,141
Shtesa	-	9,972,823	100,000	226,527					140,997,994			151,297,344
Pakesime	-	(420,660)	(254,112)	(24,583)					-			(699,355)
Transferime	-	228,982,606	-	-					(228,982,606)			-
Gjendja me 31 Dhjetor 2014	849,899,273	6,558,809,472	18,538,952	20,453,848					9,537,585			7,457,239,130
Zhvierësim i akumuluar												
Gjendja me 1 Janar 2013	-	(327,147,432)	(3,157,985)	(2,320,198)					-			(332,625,615)
Zhvierësimi i vitit	-	(292,742,955)	(3,452,673)	(3,118,536)					-			(299,314,164)
Pakesime	-	-	-	-					-			-
Gjendja me 31 Dhjetor 2013	-	(619,890,387)	(6,610,658)	(5,438,734)					-			(631,939,779)
Zhvierësimi i vitit	-	(288,002,495)	(3,012,390)	(2,841,013)					-			(293,855,898)
Pakesime	-	-	168,974	14,967					-			183,941
Gjendja me 31 Dhjetor 2014	-	(907,892,882)	(9,454,074)	(8,264,780)					-			(925,611,736)

Vlera kontabël neto

Gjendja me 01 Janar 2013	849,899,273	5,982,716,742	15,480,995	16,770,965								6,864,867,975
Gjendja me 31 Dhjetor 2013	849,899,273	5,700,384,316	12,082,406	14,813,170					97,522,197			6,674,701,362
Gjendja me 31 Dhjetor 2014	849,899,273	5,650,916,590	9,084,878	12,189,068					9,537,585			6,531,627,394

Shoqëria ka kryer punime të ndryshme gjatë vitit 2014, në vlerën 228.982.606 lek, që kanë të bëjnë me punimet në ambientet e brendshme të qendrës dhe që janë lëshuar me qera ndaj dy qiramarrësve të rinj të qendrës tregtare. Punimet që janë ende në proces deri më 31 dhjetor 2014, lidhen me punimet që po bëhen në ambientet e jashtëm të qendrës tregtare për ndërtimin e një restoranti.

TIRANA EAST GATE SH.P.K.
Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
(Vlerat janë shprehur në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)
8. Aktiv tatimor i shtyrë

Lëvizjet bruto në llogarinë e tatimeve të shtyra mbi fitimin paraqiten si më poshtë:

	<u>Pasqyra e pozicionit financiar</u>		<u>Pasqyra përmbledhese e të ardhurave</u>	
	31/12/2014	31/12/2013	31/12/2014	31/12/2013
	LEK	LEK	LEK	LEK
Aktive tatimore të shtyra				
Provizjione	2,475,012	1,157,339	1,317,674	1,157,339
Tatimi për humbjet tatimore të mbartura	10,767,012	10,927,030	(160,018)	(6,258,187)
	13,242,024	12,084,368	1,157,656	(5,100,848)
Shpenzim/(Kreditim) tatim fitimi i shtyre	-	-	1,157,656	(5,100,848)
Aktiv tatimor i shtyre, neto	13,242,024	12,084,368	-	-

Sipas legjislacionit tatimor në Shqipëri, humbjet tatimore mund të mbarten për një periudhë 3-vjecare. Aktiv i tatimor i shtyrë është njohur për humbjet e mbartura sepse ekziston mundësia që Shoqëria të gjenerojë në të ardhmen fitime të tatueshme të mjaftueshme kundrejt të cilave humbja tatimore e mbartur të përdoret.

Tabela e mëposhtme paraqet një përmbledhje të humbjeve vjetore tatimore për 4 vitet e fundit, humbjen e akumuluar të tatim fitimit në fund të çdo periudhe raportuese dhe përfundimin e afatit të njohjes.

<u>Periudha tatimore</u>	<u>(Humbja)/Fitimi vjetor i mbartur</u>	<u>Humbje të mbartura të akumuluar</u>	<u>Data e skadences</u>	<u>Aktiv Tatimor i Shtyre për humbjet e mbartura</u>
	LEK	LEK		LEK
31 Dhjetor 2012	(20,892,315)	(20,892,315)	31/12/2015	(3,133,847)
31 Dhjetor 2013	(60,397,528)	(81,289,843)	31/12/2016	(9,059,629)
31 Dhjetor 2014	(6,990,323)	(88,280,166)	31/12/2017	(1,048,548)
				(13,242,024)

9. Të drejta të arkëtueshme

Të drejtat e arkëtueshme deri më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013 janë si më poshtë:

	31/12/2014	31/12/2013
	LEK	LEK
Të drejta nga klientë	73,627,520	69,695,119
Zhvlerësim për klientë të këqinj	(14,271,858)	(21,712,561)
	59,355,662	47,982,558

Të drejta të arkëtueshme janë pa interes dhe zakonisht të arkëtueshme për një periudhë 30 ditore. Të arkëtueshmet me palët e treta janë në vlerë LEK 2,592,723 (2013: LEK 1,819,581). Ekziston një klauzolë në të gjitha marrëveshjet e qerave që çdo klient duhet të vendosë një garanci bankare ose një parapagesë për tre muaj si garanci dhe në rast të ndërprerjes së kontratës qeramarrësi nuk ka të drejtë ankimi.

Analiza e moshës për të drejtat e arkëtueshme më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013, paraqitet si më poshtë:

	Totali	As me vonesë dhe as të zhvlerësuar	Me vonesë dhe jo të zhvlerësuar			Mbi 120 ditë
			30-60 ditë	61-90 ditë	91-120 ditë	
	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK
2014	73,627,520	31,531,294	4,289,521	2,251,853	2,237,750	33,317,102
2013	69,695,119	24,904,039	2,173,501	-	3,032,874	39,584,706

TIRANA EAST GATE SH.P.K.**Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014***(Vlerat janë shprehur në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)***9. Të drejta të arkëtueshme (vazhdim)**

Shuma prej 5,816,040 LEK qe eshte zbritur nga llogarite e arketueshme ka lidhje vetem me nje klient, i cili ne te njejten kohe eshte dhe furnitor, dhe ka dhe detyrime kundrejt tij ne date 31 Dhjetor 2013. Shoqëria dhe kjo pale tjetër kanë një marrëveshje për pagese të vlerës neto të detyrimeve të ndërsjellta.

10. Të drejta tatimore dhe të tjera

	31/12/2014	31/12/2013
	LEK	LEK
TVSH e rimbursueshme	-	88,021
Të drejta tatimore të tjera	-	26,200
Parapagime tatim fitimi	20,892	20,892
	20,892	135,113

11. Parapagime të dhëna

Parapagimet e dhëna janë parapagime për shërbime të faturuara në bazë vjetore, të cilat paraqiten më poshtë:

	31/12/2014	31/12/2013
	LEK	LEK
Siguracione	1,348,435	1,419,104
Parapagime të tjera	2,524,693	-
Parapagim qiramarrësve	424,057,828	-
	427,930,955	1,419,104

Gjatë vitit 2014, Shoqëria ka paguar bonus për hyrjen si qeramarrës ndaj një shoqërie në vlerën LEK 445,050,092, sipas kontratës së qerasë që Shoqëria ka firmosur me të më 6 mars 2014, për një afat 15-vjeçar. Vlera prej LEK 424,057,828 është vlera e mbetur për tu amortizuar gjatë periudhave të ardhshme, prej të cilës LEK 27,975,366 është vlera që do amortizohet gjatë vitit 2015, dhe LEK 396,082,461 vlera e mbetur që do amortizohet për një periudhë më të gjatë se 12-muajt e ardhshëm, nga data e pasqyrave financiare. Kjo pagese, në përputhje edhe me interpretimin nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është vendosur që të trajtohet në formën e një parapagimi.

12. Të ardhura të shtyra

Të ardhura të shtyra janë të ardhura operative të përfituara në dhjetorin e vitit të kaluar dhe të faturuara në janarin e vitit të mëpasshëm.

13. Mjete monetare dhe të ngjashme

Mjetet monetare dhe të ngjashme deri më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013 paraqiten si më poshtë:

	31/12/2014	31/12/2013
	LEK	LEK
Arka		
Arka në Lek	321,369	126,596
Arka në EUR	4,750	2,369
	326,119	128,965
Banka		
Llogari rrjedhëse në Lek	52,837,869	1,388,341
Llogari rrjedhëse në EUR	123,270,854	33,935,326
	176,108,723	35,323,667
Totali	176,434,842	35,452,632

TIRANA EAST GATE SH.P.K.**Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014***(Vlerat janë shprehur në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)***14. Huatë nga institucionet financiare**

	31/12/2014	31/12/2013
	LEK	LEK
Principal i pagueshëm	3,787,626,483	3,329,214,581
Kosto financiare të shtyra	(70,122,218)	(64,984,686)
Interes i perlogaritur	61,797,687	45,975,735
	3,779,301,952	3,310,205,630

Kostot financiare të shtyra përfaqësojnë komisionet fillestare të disbursimit të huave, dhe njihen si shpenzim gjatë jetegjatesisë së huave perkatëse.

Huatë "Mezzanine" dhe "Senior" janë disbursuar totalisht në Janar 2012. Ripagesat e huave kanë filluar në 2012 dhe përfundojnë në 2017. Këto hua paguhen në monedhën euro. Si garanci ndaj huave të marra janë vendosur të gjitha aktivet e trupëzuara dhe jo të trupëzuara të shoqërisë. Huaja nga ortaku është një tjetër lloj huaje për të financuar kostot e pambuluara të projektit. Interesi i akumuluar i saj do të ripaguhet në 2017.

	31/12/2014	31/12/2013
	LEK	LEK
Huaja kryesore "Senior" - BERZH	876,996,120	1,022,058,000
Huaja kryesore "Senior" - DEG	876,996,120	1,022,058,000
Huaja në RZB	515,423,288	-
Huaja nga ortaku	267,916,569	132,115,458
Huaja "Mezzanine"	980,980,000	981,400,000
Interes i kapitalizuar për huane "Mezzanine"	223,929,145	161,499,795
Interes i kapitalizuar për huane nga ortaku	45,385,320	10,083,328
Interes i perlogaritur	61,797,676	45,975,735
Kosto financiare të shtyra	(70,122,286)	(64,984,686)
	3,779,301,952	3,310,205,630

TIRANA EAST GATE SH.P.K.**Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014***(Vlerat janë shprehur në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)***14. Huatë nga institucionet financiare (vazhdim)**

Më poshtë paraqitet klasifikimi i huave sipas maturitetit. Ndarja e detyrimeve financiare sipas maturitetit të tyre me 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 paraqitet në tabelat që vijojnë:

31/12/2014	Me pak se 1 vit LEK	1-5 vjet LEK	Mbi 5 vjet LEK	Total LEK
Huaja kryesore "Senior" - BERZH	132,992,860	744,003,260	-	876,996,120
Huaja kryesore "Senior" – DEG	132,992,860	744,003,260	-	876,996,120
Huaja në RZB	80,524,023	434,899,265	-	515,423,288
Huaja nga ortakut	-	267,916,569	-	267,916,569
Huaja "Mezannine"	-	980,980,000	-	980,980,000
Interes i kapitalizuar për "Mezannine"	-	223,929,145	-	223,929,145
Interes i kapitalizuar-huaja e ortakut	-	45,385,320	-	45,385,320
Interes i perlloritur	61,797,676	-	-	61,797,676
Kosto financiare të shtyra	(17,920,140)	(52,202,146)	-	(70,122,286)
	390,387,279	3,388,914,673	-	3,779,301,952

31/12/2013	Me pak se 1 vit LEK	1-5 vjet LEK	Mbi 5 vjet LEK	Total LEK
Huaja kryesore "Senior"-BERZH	210,580,400	811,477,600	-	1,022,058,000
Huaja kryesore "Senior"-DEG	210,580,400	811,477,600	-	1,022,058,000
Huaja nga ortakut	-	132,115,458	-	132,115,458
Huaja "Mezannine"	-	981,400,000	-	981,400,000
Interes i kapitalizuar për "Mezannine"	-	161,499,795	-	161,499,795
Interes i kapitalizuar-huaja e ortakut	-	10,083,328	-	10,083,328
Interes i perlloritur	45,975,735	-	-	45,975,735
Kosto financiare të shtyra	(19,227,168)	(45,757,518)	-	(64,984,686)
	447,909,367	2,862,296,263	-	3,310,205,630

	31/12/2014 LEK	31/12/2013 LEK
Afatgjata		
Principal i pagueshem	3,441,116,819	2,908,053,781
Kosto financiare të shtyra	(52,202,146)	(45,757,518)
Totali Afatgjata	3,388,914,673	2,862,296,263
Afatshkurtra		
Principal i pagueshem	346,509,663	421,160,800
Interesa pasive të llogaritura	61,797,676	45,975,735
Kosto financiare të shtyra	(17,920,060)	(19,227,168)
Totali Afatshkurtra	390,387,279	447,909,367
Totali	3,779,301,952	3,310,205,630

14. Huatë nga institucionet financiare (vazhdim)

Në qershor të vitit 2009 shoqëria dhe Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) kanë hyrë në një marrëveshje huaje senior dhe në një marrëveshje huaje mezzanine për financimin e investimit prej EUR 20 milion dhe EUR 7 milion, respektivisht.

Më 15 mars 2010 afatet dhe kushtet e kontratave të sipërmendura kanë ndryshuar duke bërë bashkëfinancues për huanë "Senior" financuesin gjerman DEG "Deutsche Investition und Entwicklungsgesellschaft mbH" për një shumë prej EUR 10 milion. Për rrjedhojë totali i principalit të kredisë me BERZH-in u reduktua në 10 milion Euro. Si rrjedhojë data e kompletimit fizik është shtyrë në Gusht 2011.

Sipas huase "Mezzanine", shoqëria do të paguajë interes çdo tre muaj dhe me normë interesi të ndryshueshëm që është norma Interbank + 9% përpara përfundimit të periudhës së kapitalizimit, dhe Interbank + 5% pas përfundimit të periudhës së kapitalizimit. Principali do të ripaguhet vetëm me një këst të plotë në 19 Prill 2017.

Sipas huasë "Senior", huaja do të ripaguhet në 24 këste duke filluar që nga 15 Janar 2012 dhe deri më 15 Prill 2017. Interesi do të jetë i pagueshëm çdo tre muaj dhe norma e interesit do të përcaktohet në datën respektive të pageses së interesit, duke marrë parasysh kushte të tjera që mund të ndikojnë në sistemimin e saj sipas ngjarjeve që mund të prevalojnë.

Gjatë 2012, shoqëria parashikonte që kosto totale e projektit të tejkaloheshin me EUR 211.778, shumë e cila sipas marrëveshjeve të huave midis EBRD dhe DEG do konsideroheshin si kosto të paparashikuara. Si rezultat, në 29 Qershor 2012, shoqëria dhe Mane TCI, nënshkruan një marrëveshje huaje nga ortaku, për shumën EUR 211.778, me interes 12%, e llogaritur mbi pjesën e pashlyer të principalit deri në shlyerjen përfundimtare të tij. Principal i mbetur dhe dhe interesi i akumuluar do të jenë të pagueshëm ndaj Mane TCI në disa këste përpara shpërndarjes së dividendëve, por në asnjë rast më vonë se 5 vjet nga data e disbursimit.

Gjate vitit 2013 Mane TCI rriti kreditimin ndaj Shoqërisë duke nënshkruar kontrata të reja kredie për financimin e punimeve për projektet e Cineplexx dhe Inditex. Jane nënshkruar dy kontrata të tilla me vlerë 200,000 euro dhe 1mln euro. Keto kredi bashke me interesin e akumuluar do të ripaguhet në 15 Mars 2019.

Në korrik 2014, Shoqëria ka marrë pranë "Raiffeisen Bank" një kredi afatgjatë, në vlerën e EUR 3,925,000, me një afat maturimi prej 6 vitesh. Paguesa e kësaj kredie ka nisur në tetor 2014. Kredia është për t'u paguar çdo tre-mujor, pas datës së parë të pagesës (15 tetor 2014), deri në maturimin e saj (15 janar 2019). Sipas marrëveshjes së huasë, Shoqëria do të paguajë interes çdo tre muaj, dhe me normë interesi të ndryshueshëm, që është norma Interbank + 6.25%.

Gjatë vitit 2014 Mane TCI e rriti përsëri kreditimin e Shoqërisë duke nënshkruar një kontratë të re kredie në vlerën e EUR 969,442, për të mbuluar punimet shtesë që u kryen në qendrën tregtare për rregullimet e ambienteve që u lëshuan me qera ndaj Cineplexx dhe "ITX Albania shpk" (shënim 7). Gjendja totale e huasë ndaj Mane TCI më 31 dhjetor 2014 është LEK 267,916,569 (EUR 1,911,778) për vlerën e principalit të papaguar, dhe LEK 45,385,320 (EUR 323,857) për vlerën e interesit të kapitalizuar.

Kovenantet

Marrëveshjet përfshijnë disa kovenante të grupuara në kovenante pohuese, kovenante mohuese, kërkesa raportimi dhe kovenante financiare.

- Kovenantët pohuese përfshijnë: mbajtjen dhe drejtimin të duhur të shoqërisë; blerjen dhe rinovimin e policave të përshtatshme të sigurimit për parandalimin e humbjeve; angazhimin e një auditimi të pavarur për të siguruar që regjistrimet financiare të jenë ato të duhurat dhe dhe që ekzekutimi i projektit është bërë sipas marrëveshjes me BERZH.
- Kovenantet financiare përfshijnë: mbajtjen e një niveli të përcaktuar të raportit aktual të mbulimit të huasë, përmbushjen e angazhimit në datën e caktuar; mbajtjen në një nivel të caktuar të raporteve të levave financiare, raporteve të kostos së kredive, dhe raportet e vlerave të kredisë.
- Kovenantët kyçe negative përfshijnë: kufizimet në shpërndarjen e dividendëve; kërkesat për të autorizuar kryerjen e shpenzimeve; marrja e angazhimeve; hyrja në transaksione derivative; shitja e aktiveve apo marrja e qerave financiare me një shumë më të madhe se EUR 100 mijë; kufizimet për marrjen e borxheve të tjera përveç atyre të marra sipas marrëveshjeve financiare; kufizimet për lëshimin e aktiveve të shoqërisë si garanci dhe të tjera.
- Gjatë fazës së ndërtimit, shoqëria mëmë dhe shoqëria mëmë finale duhet të mbajnë disa tregues financiarë përmbi një niveli të përcaktuar, kjo gjatë periudhës së zbatimit të projektit këta tregues përfshijnë aktivet likuide dhe aktivet neto. Megjithatë pas përfundimit të projektit shoqëria mëmë dhe shoqëria mëmë finale janë të lira nga çdo detyrim.

14. Huatë nga institucionet financiare (vazhdim)

Data e përfundimit fizik të projektit është 20 dhjetor 2013 dhe “raportet e mbulimit të shërbimit të borxhit” janë të aplikueshme në 2014. Shoqëria është në përputhshmëri me kovenantet e aplikueshme deri më 31 dhjetor 2014, përveç kovenanteve që lidhen me Shoqërinë mëmë, e cila është në proces auditimi deri në datën që janë aprovuar keto pasqyra financiare.

15. Kapitali aksionar**Numri dhe vlera nominale e aksioneve të regjistruara më 31 dhjetor 2014**

Më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 kapitali aksionar i autorizuar dhe i regjistruar i Shoqërisë është në vlerën LEK 3,353,338,000. Numri total i kuotave është 33,533,380 me vlerë LEK 1,000 për kuotë.

Aksionarët

Tabela e mëposhtme paraqet pozicionin e aksionerëve të TEG dhe kontributet e kryera më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013, në eLEK:

Aksionarët	% Kuotave	Kapitali i regjistruar ne LEK (kontributi i paguar)	
		31/12/2014	31/12/2013
MANETCI	88.10%	2,954,123,382	2,954,123,382
AAEF	8.90%	298,614,478	298,614,478
Financial Investment Servis	3.00%	100,600,140	100,600,140
Total	100%	3,353,338,000	3,353,338,000

16. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore deri më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013 paraqiten si më poshtë:

	31/12/2014	31/12/2013
	LEK	LEK
Tatimi mbi të ardhurat personale	36,652	30,992
Sigurimet shoqërore	73,568	69,015
Tatim në burim	-	16,250
TVSH e pagueshme	1,858,280	6,977,020
	1,968,500	7,093,277

17. Furnitorë dhe të tjera detyrime

Furnitorë dhe të tjera detyrime deri më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013 përbëhen si më poshtë:

	31/12/2014	31/12/2013
	LEK	LEK
Furnitorët	284,418,212	310,128,367
Shpenzime te perllogaritura	11,474,675	9,407,392
Furnitorë- Fatura të pambërritura	1,114,368	1,615,993
Detyrime te tjera	10,360,307	7,791,399
	295,892,887	319,535,759

Termat dhe kushtet për furnitorë dhe detyrime të tjera:

- Llogaritë e furnitorëve nuk janë interes-mbajtëse dhe maturohen brenda 30 ose 60 ditëve.
- Fatura të pambërritura nuk janë interes-mbajtëse dhe kanë një kohë vonese deri në 60 ditë.
- Nga llogaritë e pagueshme detyrimi kundrejt palëve të lidhura shuma është LEK 254,144,430 (2013: LEK 272.332.595).(shënimi 28)

TIRANA EAST GATE SH.P.K.**Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014***(Vlerat janë shprehur në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)***18. Parapagime të marra**

Në parapagimet e marra përfshihen depozitat në para nga qeramarrësit e qendres tregtare, si një garanci ndaj detyrimeve financiare që lindin prej kushteve të qerasë, të cilat janë të pakthyeshme dhe zgjasin gjatë gjithë periudhës së qeramarrjes.

	31/12/2014	31/12/2013
	LEK	LEK
Parapagesat e qerasë si garanci	19,932,635	24,274,400
	19,932,635	24,274,400

19. Të ardhurat nga shërbimet

Të ardhurat nga shërbimet për periudhën deri më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013 përbëhen si më poshtë:

	31/12/2014	31/12/2013
	LEK	LEK
Të ardhura nga qeratë	632,920,507	566,682,814
Të ardhura nga shërbimet	200,874,858	187,388,873
Të ardhura nga promocionet	65,119,241	64,975,032
Të ardhura shërbimet operative	6,729,534	4,648,942
	905,644,140	823,695,661

Gjatë vitit 2014, tek të ardhurat nga qeratë është debituar vlera LEK 20,852,265, pasi përfaqëson shpenzimin që i përket vitit raportues për bonusin e hyrjes së "ITX Albania shpk" si qeramarrës i qendrës tregtare.

20. Të ardhura të tjera

Të ardhura të tjera për periudhën deri më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013 paraqiten si më poshtë:

	31/12/2014	31/12/2013
	LEK	LEK
Te ardhura nga shitja e aktiveve afatgjata	95,392	-
Te ardhura te tjera	2,009,118	531,108
	2,104,510	531,108

21. Shërbime

Shërbimet për periudhën deri më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013 përbëhen si më poshtë:

	31/12/2014	31/12/2013
	LEK	LEK
Shërbime konsulence	50,656,896	47,503,621
Marketing dhe publicitet	50,299,548	55,862,996
	100,956,444	103,366,618

22. Shërbime operative

Shërbimet operative për periudhën deri më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013 përbëhen si më poshtë:

	31/12/2014	31/12/2013
	LEK	LEK
Energji dhe ujë	49,679,880	48,072,387
Pastrime ambjenti	22,212,414	23,134,808
Shërbime ruajtje	14,492,647	12,888,631
Transport	32,464,500	32,698,950
	118,849,441	116,794,776

TIRANA EAST GATE SH.P.K.**Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014***(Vlerat janë shprehur në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)***23. Shpenzime për personelin**

Shpenzimet e personelit për periudhën deri më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013 përfshijnë si më poshtë:

	31/12/2014	31/12/2013
	LEK	LEK
Pagat e personelit	4,431,866	3,622,863
Kontributet e sigurimeve shoqërore	538,938	471,805
	4,970,804	4,094,668

24. Shpenzime të tjera operative

Shpenzime të tjera operative për periudhën deri më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013 përfshijnë si më poshtë:

	31/12/2014	31/12/2013
	LEK	LEK
Taksa vendore	19,090,120	9,555,120
Mirembajtje	30,611,276	30,111,366
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	1,197,491	1,496,664
Shpenzime sigurim prone	2,728,257	3,447,918
Pritje dhe dhurata	174,355	433,577
Shpenzime zyre dhe kancelari	748,771	528,886
Komisione bankare	656,126	817,448
Penalitete	10,896	204,608
Udhetime dieta	61,180	-
Te tjera	8,568,207	8,253,535
	63,846,679	54,849,121

25. Fitim/Humbje neto nga kurset e këmbimit

Teprica për periudhën deri më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013 paraqitet si më poshtë:

	31/12/2014	31/12/2013
	LEK	LEK
Fitime nga ndryshimi i kurseve të këmbimit	2,574,460	3,809,906
Humbje nga ndryshimi i kurseve të këmbimit	(1,290,464)	(19,140,671)
	1,283,997	(15,330,765)

26. Shpenzime dhe të ardhura financiare, neto

Teprica për periudhën deri më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013 paraqitet si më poshtë:

	31/12/2014	31/12/2013
	LEK	LEK
Te ardhura financiare	(25,873)	(74,161)
Shpenzime financiare	335,978,564	279,926,277
	335,952,691	279,852,116

Per periudhen deri me 31 dhjetor 2014, shpenzimet per interesa jane ne vleren LEK 317,419,163 (31 dhjetor 2013: LEK 259,287,634).

TIRANA EAST GATE SH.P.K.
Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
(Vlerat janë shprehur në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)
27. Tatim fitimi

Tatim fitimi përbëhet si më poshtë:

	31/12/2014	31/12/2013
	LEK	LEK
Shpenzim tatimor per periudhen	-	109,108
(Kreditim i shpenzimit)/Shpenzim tatimor te shtyre	(1,157,656)	5,100,848
Total	(1,157,656)	5,209,956

Llogaritja e tatimit aktual dhe tatimit të shtyrë për periudhën deri më 31 dhjetor 2014 dhe 31 dhjetor 2013 përbëhet si më poshtë:

	31/12/2014	31/12/2013
	LEK	LEK
Humbje kontabel per periudhen	(23,655,675)	(71,058,741)
Shpenzime te pazbritshme	16,665,352	10,661,213
Humbje tatimore per periudhen	(6,990,323)	(60,397,528)
Humbje tatimore te mbartura	(81,289,843)	(171,852,168)
Zvogelimi I humbjes per periudhat sipas kontrollit		113,127,872
Skadim I humbjes tatimore te mbartur	-	16,939,667
Humbje tatimore e mbartur e akumuluar	(88,280,166)	(102,182,157)
Humbje te mbartura qe parashikohen te parikuperueshme	-	20,892,315
Norma e tatim fitimit (15%) (2012: 10%)	(13,242,024)	(12,193,476)
Tatim fitim per vitet e kaluara sipas Akt Kontrollit		109,108
Totali i aktivitet tatimor te shtyre	(13,242,024)	(12,084,368)

Llogaritja e normës efektive të tatimit:

	31/12/2014	31/12/2013
	LEK	LEK
Humbje kontabel per periudhen (para kontrollit)	(23,655,675)	(71,058,741)
Norma e tatim fitimit (15%) (2012: 10%)	(3,548,351)	(10,658,811)
Shpenzime te pazbritshme	2,499,803	1,599,182
Zvogelimi i humbjes per periudhat sipas kontrollit	-	11,312,787
Skadim i humbjes tatimore te mbartur	-	1,693,967
Efekt i ndryshimit ne normen e tatim fitimit per humbjen e mbartur te 2012	-	(1,044,616)
Efekt i humbjes tatimore te periudhes qe do mbartet ne periudhat e ardhshme	(1,048,548)	2,902,509
Humbje te mbartura qe parashikohen te parikuperueshme	-	2,089,231
Tatim fitim per vitet e kaluara sipas Akt Kontrollit	(109,108)	109,108
Shpenzimi i tatim fitimit	(1,157,656)	5,100,848

TIRANA EAST GATE SH.P.K.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Vlerat janë shprehur në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

28. Palët e lidhura

